



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0310

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Agon Ramadani, Kryetar i Panelit, dukevendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) D.P.H. “Visari”, me seli në Lipjan, kundër Vendimit për dhënie të kontratë të Kuvendi Komunal Lipjan në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e byfësë në ndërtesën e Komunës Lipjan” me numër të prokurimit 613-23-3030-2-2-1, me 22/08/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE D.P.H. “Visari” me nr. 2023/0310, e datës 26/05/2023, kurse vendimi i AK Kuvendi Komunal Lipjan lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e byfësë në ndërtesën e Komunës Lipjan” me numër të prokurimit 613-23-3030-2-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik D.P.H. “Visari”.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 31.03.2023, Kuvendi Komunal Lipjan, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë. Me datën 03.04.2023, AK ka publikuar formularin për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara. Hapja e ofertave është bërë me datë 25.04.2023, Me datë 12.05.2023, AK ka publikuar B58 Njoftimin Mbi Vendimin për dhënie të kontratës se aktivitetit të prokurimit “Shërbimet e byfësë në ndërtesën e Komunës Lipjan” me numër të prokurimit 613-23-3030-2-2-1, ku është rekomanduar për kontratë OE “Fexhri Luma B.I”.

Me datë 16.05.2023, Operatori Ekonomik D.P.H. "Visari", ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK- Kuvendi Komunal Lipjan dhe me datë 18.05.2023, Autoriteti Kontraktues, Kuvendi Komunal Lipjan, eka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar B58 njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 12.05.2023.

Me datën 26.05.2023, Operatori Ekonomik D.P.H. "Visari", ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 310/2023, për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës 32,000 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Palët janë njoftuar me raportin e ekspertizës me datë: 07 qershor 2023, AK, Kuvendi Komunal Lipjan, me 14.06.2023, ka deklaruar se nuk pajtohem me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkah OE D.P.H. "Visari", me datë 12.06.2023, ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 07.06.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE D.P.H. "Visari", të aprovohet pjesërisht si e bazuar.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 12.05.2023, dhe lënda të kthehet në rivlerësim (*njoftimi për dhënie të kontratës*).

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues D.P.H. "Visari"

Përgjigje në pretendimi nr.1

OE "DPH Visari "-Lipjan, - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Lipjan nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së ,

Eksperti thekson se nder të tjera qellim i këtij neni është te siguroj qe fondet publike dhe burimet publike të përdoren ne mënyrë me ekonomike ,duke e marr ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit, andaj shpallja e OE fitues sa i përket këtij neni nuk ishte ne kundërshtim me nenin 6 të LPP-së. Eksperti konstaton se OE vetëm sipërfaqësisht e ka përmendur këtë nenë pa pasur ndonjë pretendim se qka nuk ishte në harmoni me këtë dispozitë Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimi nr.2

OE "DPH Visari "-Lipjan, - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Lipjan nuk e ka respektuar nenin 56 të LPP-së. OE ankues pretendon se : Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar ne kundërshtim me neni 56 , paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 te LPP-se ne Republikën e Kosovës. Në vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 te këtij ligji. Të gjitha kontratat publike që të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

1.1. së pari, vlerësimi të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

Eksperti sqaron se me te drejtë OE ankues i ka sqaruar qëllimin e këtyre dy paragrafëve ,sa i përket pretendimit i njëjti qëndron sepse OE i shpallur fitues nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e kualifikimit te specifikuara në NJK dhe dosjen e tenderit, sepse te lista e kontratave mungon çmimi siç ishte paraparë me NJK dhe Dosjen e tenderit mungon shumat e kontratës ,gjithashtu shumat apo vlera e kontratës nuk specifikohet as në marrëveshjet dhe e njëjta nuk specifikohet as në referenca ,edhe sa i përket pretendimit 1.2 vlerësimi i tenderëve nuk ishte ne harmoni me nenin 60 qe nënkupton kriterin bazuar ne çmimin me te lirë ,pra OE i shpallur fitues nuk ishte ne harmoni me nenin 60 sepse e njëjta ndërlidhet me kushtet e kualifikimit ishte oferta me çmim ma te lirë por AK pa u siguruar se i plotëson kërkesat e kualifikimit nuk mundë të shpallet fitues te njëjtin kur nuk plotësohen kriteret e parapara me NJK dhe DT. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i bazuar.

Përgjigje në pretendimi nr.3 OE "DPH Visari" Lipjan, - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Lipjan nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së. OE ankues pretendon se OE fitues nuk i ka plotësuar këto tri (3) kritere:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Raporti mbi fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik dhe numrin mesatar të personelit të angazhuar për periudhën e fundit (2020, 2021, 2023), duhet ti ketë të punësuar minimum a. (1) banakierë dhe b. (1) kamarierë;	1. Një pasqyrë tabelorë e personelit e nënshkruar dhe vulosur - (original), të prezantohet dëshmi. a. Për banakierë dhe Kamarier kontratat e punës (kopje).
2. Operatoret ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë përfunduar së paku një kontratë për shërbime të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit.	2. Listën e kontratave që specifikon shërbimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin, duke ia bashkëngjitur dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat e cekura në listë, (kopje).
3. Librezat sanitare për gjendjen shëndetësorë të punëtorëve .	3. Librezat sanitare nga Instituti Kombëtar i Shëndetësi (higjienës).

Sa i përket pikës së parë (1) ,Eksperti sqaron se i njëjti nuk qëndron sepse OE i shpallur fitues ka prezantuar stafin -personelin për bankier dhe kamarier si dhe ka prezantuar edhe kontratat e punës së stafit ashtu siç ishte paraparë me NJK dhe DT si dëshmi se bashku me ofertë e gjeni listën e stafit dhe kontratat e punës në ofertën e OE të shpallur fitues. Andaj, eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Sa i përket pikës së dytë (2) , Eksperti sqaron se sa i përket pretendimit i njëjti qëndron sepse OE i shpallur fitues nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e kualifikimit të specifikuar në NJK dhe dosjen e tenderit, sepse te lista e kontratave mungon çmimi siç ishte paraparë me NJK dhe Dosjen e tenderit mungon çmimi -shuma e kontratës ,gjithashtu shuma apo vlera e kontratës nuk specifikohet as në marrëveshjet e dorëzuara qe janë specifikuar në listën e kontratave dhe e njëjta nuk specifikohet as në referenca. Andaj,eksperti konstaton se ky pretendim është i bazuar.

Sa i përket pikës së tretë (3) dhe pretendimit se Librezat e sanitarisë janë kërkuar me sqarime shtesë dhe te njëjtat janë nxjerr pas publikimit te njoftimit për kontratë , Eksperti sqaron se në platformën e e-prokurimit nuk ka vërejtur ndonjë kërkesë për sqarime lidhur me librezat e sanitarisë dhe nuk ka vërejtur se ka pasur ndonjë sqarim nga OE i shpallur fitues ,andaj eksperti konstaton se si pikë pretenduese sa i përket librezave te sanitarisë është e pranueshme sepse me ofertë janë vetëm faktuarat mbi pagesën e librezave kurse librezat nuk gjinden ne platformën e-prokurimit dhe derisa nuk janë librezat ne ofertë dhe ne platformë nuk shihen te ngarkuara me sqarime siç janë përmendur edhe pretendimi i OE ankues është i bazuar. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i bazuar. Pasi që dy nga tri pikat e përmendura ne nenin 59 te LPP-së janë të bazuara Eksperti konstaton se vlerësimi nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimi nr.4 OE "DPH Visari "-Lipjan, - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Lipjan nuk e ka respektuar nenin 115 të LPP-së

OE ankues nderë te tjera pretendon se :

AK me rastin e refuzimit te kërkesës për rishqyrtim ka bërë shkelje te nenit 115.2 sepse nder tjera ne kemi ngritë shumë pretendime dhe nëse i qasemi arsytimit te vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim shohim se AK nuk ka bërë vlerësimin detal mbi vlefshmërinë e asnjërit pretendim, gjithashtu nuk u bë një verifikim lidhur me listën e kontratave qe OE konsideron se janë fiktive.

Eksperti sqaron se neni 115 paragrafi 2 aplikohet pas hartimit te raportit te ekspertit dhe pikat pretenduese nuk kanë të bëjnë me këtë fazë të lendes, mirëpo sa i përket pretendimit se nuk janë shqyrtuar ne detale pretendimet ne kërkesën për rishqyrtim eksperti sqaron nuk ka pasur arsytim bindës nga ana e AK ,por megjithatë ka pasur përgjigjeje te përgjithësuara ku edhe është arsyetuar duke e ndërlidhë me hierarkinë ligjore ku është përmendur dispozitat ligjore dhe rregullat e nxjerra nga KRPP.

Lidhur me listën kontratave qe OE ankues pretendon se janë fiktive eksperti sqaron se a janë fiktive apo jo nuk është nën kompetencat e ekspertit shqyrtues por te organeve tjera. Andaj eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimi nr.5

OE "DPH Visari"-Lipjan, - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Lipjan nuk e ka respektuar nenin 72 të LPP-së

OE ankues pretendon se AK ka kërkuar sqarime për listën e kontratave dhe OE i shpallur fitues i ka dërguar listën e kontratave komfor kërkesës me vlere por pa datë të përpilimit të listës që do te thotë se ka dorëzuar listë ne kundërshtim me nenin 71.3 te LPP-së sepse lista e dorëzuar pa date dhe referenca e dorëzuar me date 01.03.2023 nuk mund te verifikohet ekzistenca e fiksuar para skadimit te afatit për dorëzimin e tenderëve.

Eksperti sqaron se ky pretendim i OE ankues përkatësisht këto sqarime nuk shihen ne platformën e e-prokurimit dhe për te njëjtat nuk mund të jap ndonjë sqarim përveç asaj se çka janë dorëzuar me rastin e dorëzimit te ofertave dhe se siç e kam sqaruar ne përgjigjejen numër 3 se: pika e dytë se si pretendim është i bazuar referoju pikës së dytë te përgjigjja nr 3.te këtij raporti. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.5

OE "DPH Visari "-Lipjan, - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Lipjan nuk e ka respektuar nenin 38 RRPP dhe neni 10 i Udhëzuesit për prokurim publik

OE ankues pretendon se: Duke u bazuar ne nenin 38.3 te Rregullores i cili shprehimisht përcakton se këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate, i cili ne rastin konkret Publikimi i Njoftimit për kontratë është bërë ne Platformën e —prokurimit me date 31.03.2023 si dhe duke u bazuar ne dëshmitë dokumentare lidhur me Kërkesën e AK-se, se OE duhet te ofroj dëshmi për Librezat sanitare shohim se OE ka dorëzuar kopjet e librezave sanitare te cilat i nxjerr nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë me date 25.04.2023 për Florent Lumen, Rinor ,Banullën, Fixhri Lumen, Bardhyl Trollin te cilat janë nxjerr pas publikimit te njoftimit për kontratë.

Eksperti sqaron se për këtë pikë pretenduese është dhënë përgjigjeja te pika 3 në përgjigjjen-pretendimin nr.3 te këtij raporti. Andaj eksperti konstaton se është pretendim i bazuar .

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrësas dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se AK nuk vepruar konform dispozitave të cituara si më sipër, të precizuara dhe të argumentuara ato në ankesë dhe në raportin e ekspertit shqyrtues. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP. Raporti i ekspertit shqyrtues nuk prodhon efekte detyruese për asnjërën nga palët dhe as për panelin shqyrtues, prandaj i njëjti (natyrisht dhe vlerat provuese të tij) gjithnjë analizohen në raport me të gjitha shkresat e një lënde, me rrjedhën e procesit të prokurimit, veprimet e palëve, qëllimin dhe natyrën e një aktivitetit të prokurimit, i cili në parim synon përmbushjen e nevojave publike, me përdorimin e fondeve publike, të cilat i janë besuar secilit AK, në cilin do nivel.

Prandaj pretendimet ankimore dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, sipas këtij Paneli, gjejnë mbështetje në legjislacionin primar dhe sekondar për prokurimin publik, andaj pohimet ankimore konsiderohen të bazuara, kështu që rrjedhimisht lënda kthehet në rivlerësim duke u bazuar në arsyetimet e dhëna nga eksperti shqyrtues.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - D.P.H. " Visari "**
- Arkivës së OSHP-së: